



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. \_\_ 63 \_\_ Prot.

**UDHËZIM**

Nr. \_03\_, Datë \_11. 04. 2017

I MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR. 02, DATË 30.11.2017

**PËR**

**PËR HARTIMIN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE  
KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT**

**Viti 2017**

## **A. Përmbajtja e Udhëzimit**

<b>I.</b>	Hyrje.	3
<b>II.</b>	Përmbajtja e programit kombëtar	3
<b>III.</b>	Përgatitja e programit kombëtar	4
<b>IV.</b>	Vlerësimi i programeve kombëtare	7
<b>V.</b>	Grupi i eksperteve	8
<b>VI.</b>	Miratimi i programeve kombëtare	10
<b>VII.</b>	Financimi i programeve kombëtare	12
<b>VIII.</b>	Zbatimi, ndjekja dhe raportimi për programet kombëtare	14

## **B. Anekset**

<b>I.</b>	Gjendja ekzistuese në fushën përkatëse të kërkimit e të zhvillimit.	17
<b>II.</b>	Motivimi i ndërmarrjes së programit;	17
<b>III.</b>	Drejtimet parësore të kërkimit e të zhvillimit teknologjik;	17
<b>IV.</b>	Objektivat e kërkimit dhe të zhvillimit.	18
<b>V.</b>	Financimi	20
<b>VI.</b>	Skeda Informative e programit;	22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

Nr. \_\_ 63 \_\_ Prot

**UDHËZIM**

Nr\_03\_, Datë\_11. 04. 2017

**PËR  
HARTIMIN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE KOMBËTARE TË  
KËRKIMIT DHE TË ZHVILLIMIT**

Në bazë të Ligjit Nr. 7893, datë 22.12.1994, "Për Shkencën dhe Zhvillimin Teknologjik", VKM. Nr. 607, datë 31.08.2016, "Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit", (AKKSHI), dhe në bazë të VKM Nr. 567, datë 23. 10.1995, "Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike", Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

**UDHËZON:**

**I. HYRJE**

1. Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit (këtu më poshtë - Programet Kombëtare) janë paraqitje sintetike e veprimtarive sistematike kërkimore dhe zhvillimore, që ndërmerren për të arritur objektiva të caktuar në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin e vendit.
2. Programet Kombëtare mbështesin në aspektin kërkimor dhe zhvillimor Programin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit.
3. Programet Kombëtare zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit.

**II. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT KOMBËTAR**

Programi Kombëtar përshkruan:

- Gjendjen ekzistuese në fushën përkatëse në vend dhe në botë;
- Motivimin e ndërmarrjes së programit;
- Drejtimet përparësore të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik sipas fushës së veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore dhe fushës së veprimtarisë shkencore;
- Objektivat e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik;
- Rezultatet e pritshme;
- Ndikimin e pritshëm të këtyre rezultateve në zhvillimin social-ekonomik;
- Burimet njerëzore dhe financiare.

Programi Kombëtar hartohet duke i'u përmbajtur skemës dhe rubrikave të paraqitura në shtojcën (Mod PR 01).

### **III. PËRGATITJA E PROGRAMIT KOMBËTAR**

#### ***Shpallja e Fushave Përparësore dhe e Programeve Kombëtare***

1. Bordi i Administrimit (BA) i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) në kuadrin e politikës shkencore e teknologjike, miraton fushat parësore në të cilat do të hartohen Programe Kombëtare si dhe fondet e nevojshme për funksionimin e grupeve që do të hartojnë Programet Kombëtare, të cilat vihen në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (më poshtë AKKSHI), shpall fushat parësore, për të cilat do të hartohen Programe Kombëtare.
3. AKKSHI si institucion qendror përgjegjës për secilën fushë parësore përcakton numrin e Programeve Kombëtare që do të hartohen, bën emërimin dhe shpalljen e tyre, duke përcaktuar për çdo vit afatet e dorëzimit të tyre.

#### ***Grupi i Programit Kombëtar***

- AKKSHI, përcakton grupin e punës për përgatitjen e Programit Kombëtar (me poshtë Grupi i Programit).
- Anëtarët e Grupit të Programit zgjidhen ndërmjet shkencëtarëve e specialistëve më të mirë të vendit.
- Në Grupin e Programit mund të angazhohen si anëtarë dhe shkencëtarë edhe ekspertë të huaj.

#### ***Miratimi i Grupit të Programit***

- Numri, përbërja dhe kryetari i Grupit të Programit miratohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t për Programin Kombëtar përkatës duke marrë pëlqimin paraprak të vetë personave.
- Në urdhër përcaktohen edhe fondi i nevojshëm për funksionimin dhe veprimtarinë e grupit, shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të tij, si dhe afati i përfundimit të programit të dhënë.

#### ***Kontrata me Grupin e Programit***

- AKKSHI lidh një kontratë (shih shtojcën, Mod. PR 03) me Grupin e Programit në të cilën përcaktohen afati dhe kushtet e kryerjes së detyrës (si rregull pa shkëputje nga puna), shpërblimi i anëtarëve të Grupit të Programit, detyrimet reciproke, etj., në bazë të urdhërit përkatës (paragrafi 6).

### ***Ndjekja e veprimtarisë dhe mbështetja e Grupit të Programit***

- AKKSHI ndjek e mbështet veprimtarinë e Grupit të Programit dhe i jep gjithë ndihmën e nevojshme që kërkohet nga Grupi sipas urdhërit dhe kontratës që nënshkruhet prej palëve.
- Ata caktojnë nga një përfaqësues të tyre për ndjekjen e veprimtarisë dhe mbështetjen e Grupit të Programit i cili merr pjesë edhe në mbledhjet më të rëndësishme të tij.
- AKKSHI i vë në dispozicion Grupit të Programit mjedise pune, e mbështet atë me literaturë, materiale shkresore dhe i krijon lehtësitë e nevojshme për komunikim dhe shtypje materialesh.
- Këto pasqyrohen në kontratën që lidhet me Grupin e Programit (paragrafi 7)

### ***Veprimtaria e Grupit të Programit***

- Grupi i Programit, duke u mbështetur në politikën shkencore dhe teknologjike, në programin e Qeverisë për zhvillimin e vendit dhe në politikat sektoriale të zhvillimit, përcakton drejtimitet e kërkimit e të zhvillimit teknologjik në fushën përkatëse, objektivat e kërkimit sipas çdo drejtimi dhe harton Projekt-dokumentin e Programit Kombëtar përkatës, sipas skemës së paraqitur në shtojcën 1 të këtij udhëzimi (Mod. PR 01).
- Projekt-dokumenti i Programit depozitohet nga Grupi i Programit në AKKSHI.
- AKKSHI, vë në dijeni për projekt-dokumentin e programit të hartuar institucionet qendrore, Akademinë e Shkencave, institucionet kërkimore shkencore dhe firmat prodhuese që mund të jenë të interesuara.
- Institucioneve të sipërpërmendura u kërkohet që brenda një muaji të bëjnë vërejtje të argumentuara për projekt programin, të propozojnë ndryshime ose plotësime të projekt programit në përgjithësi dhe, në veçanti për drejtimitet e kërkimit dhe objektivat sipas çdo drejtimi.
- Institucionet kërkimore shkencore dhe në përgjithësi njësitë shkencore në përbërje të tyre, njësitë shkencore të firmave prodhuese, etj., ftohen t'i dërgojnë Grupit të Programit propozime për probleme kërkimi që ato dëshirojnë të trajtojnë në kuadrin e Programit Kombëtar, në përputhje me drejtimitet e kërkimit dhe objektivat e tyre, duke përcaktuar rezultatet e pritshme të kërkimit.
- Në propozim përfshihet edhe parashikimi për mbështetjen financiare të kërkimit nga buxheti i shtetit dhe, nëqoftëse ka, financimi i parashikuar ose i siguruar nga burime të tjera të vendit ose të huaja.
- Grupi i Programit shqyrton, përpunon dhe analizon informacionin e marrë nga të gjitha institucionet dhe njësitë shkencore të përmendura në paragrafet 12 e 13, bën ndryshime e plotësime në projekt program, kur e gjykon të arsyeshme e të nevojshme dhe harton dokumentin përfundimtar të Programit Kombëtar, sipas kërkesave të paraqitura në shtojcën 1 “Formulari i Programit Kombëtar për Kërkim e Zhvillim” (Mod. PR 01).
- Grupi i Programit, më parë se të hartojë dokumentin përfundimtar, mbas marrjes dhe shqyrtimit të informacionit prej njërive shkencore dhe, kur e gjykon të

arsyeshme, thërret në konsultë, me mbështetjen e AKKSHI-t, përfaqësues të institucioneve të interesuara që përmenden në paragrafet 11 e 13. Në konsultë Grupi i Programit jep shpjegimet e tij për programin dhe dëgjon mendimet e pjesmarrësve për të.

### ***Dorëzimi i Programit Kombëtar***

- Grupi i Programit harton dokumentin përfundimtar të Programit Kombëtar, që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij.
- Grupi i Programit mbasi përfundon dokumentin e Programit Kombëtar i'a përcjell atë AKKSHI-t.
- Dokumentat e tjera që disponon Grupi i Programit ia dorëzon MAS.

### ***Kontrolli formal paraprak***

- AKKSHI, Drejtoria e Programeve Kombëtare (DPK) mbas marrjes së Programit Kombëtar prej Grupit të Programit, bën kontrollin formal të paraqitjes së dokumentit të programit sipas kërkesave të formularit përkatës.
- Në rast se gjenden parregullsi në paraqitjen formale, dokumenti i programit së bashku me vërejtjet, brenda 5 ditëve i kthehet për plotësim ose rregullime Grupit të Programit.
- Grupi i Programit brenda 7 ditëve është i detyruar t'ja kthejë AKKSHI-t Programin Kombëtar të rregulluar dhe të plotësuar.

### ***Të drejtat dhe detyrat e Grupit të Programit***

- Për përgatitjen e Programit Kombëtar, Grupi i Programit ka keto të drejta dhe detyrime :
  - a. të kërkojë informacione dhe dokumentacione plotësuese nga ministritë ose institucionet qendrore, institucionet shkencore dhe shkollat e larta të fushës që mbulon Programi Kombëtar për përgatitjen dhe plotësimin e programit;
  - b. të bëjë takime me drejtues të ministrive ose të institucioneve qendrore dhe të institucioneve shkencore, me këshillat drejtues dhe shkencore të institucioneve shkencore, me drejtues të njëjësive shkencore e me punonjës shkencorë, drejtues të ndërmarrjeve e të firmave prodhuese ose të shërbimit shkencor e teknologjik, etj.
  - c. të vizitojë institucione shkencore, laboratorë, etj., për të parë në vend përshtatshmërinë e infrastrukturës dhe të potencialit shkencor e teknologjik të tyre për të zhvilluar veprimtarinë kërkimore;
  - d. të verifikojë informacionin dhe propozimet që merr nga njësitë kërkimore të përmendura në paragrafin 13 duke shfrytëzuar edhe veprimtarinë e kryera prej tij sipas pikave b dhe c të këtij paragrafi;
  - e. të organizojë konsulta dhe seminare me përfaqësues të ministrive dhe institucioneve qendrore të institucioneve shkencore dhe të shkollave të larta, përfaqësues të ndërmarrjeve e të firmave prodhuese, etj.
  - f. të japë shpjegimet e nevojshme para komunitetit shkencor dhe organizmave shtetërore.

- g. të evidentojë dhe të rekomandojë financime për Programin Kombëtar nga burimet e financimit të përcaktuara në paragrafin VII.2.
- Përcjelljen e shkresave dhe të materialeve të domosdoshme ai e kryen me anë të sekretarisë së ministrisë ose institucionit qendror përgjegjës për Programin Kombëtar përkatës.

### ***Kryetari i Grupit të Programit***

Kryetari i Grupit të Programit :

- organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Programit;
- harton planin e veprimtarisë së Grupit të Programit duke përcaktuar detyrat e secilit anëtar dhe ia paraqet Grupit të Programit për miratim;
- thërret mbledhjet e Grupit të Programit;
- përfaqëson Grupin e Programit në marrëdhëniet me ministrinë ose institucionin qendror përgjegjës dhe institucionet e tjera;
- i propozon titullarit të AKKSHI-t zëvendësimin e anëtarëve të Grupit të Programit ose shtimin e tyre dhe merr miratimin e tij dhe;
- kujdeset për ruajtjen e dokumentave të punës;
- njofton AKKSHI-n për mbledhjet më të rëndësishme të Grupit të Programit.

## **IV. VLERËSIMI I PROGRAMEVE KOMBËTARE**

### ***Kuptimi i procesit të vlerësimit***

Vlerësimi i Programeve Kombëtare është pjesë përbërëse e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike që ka për qëllim të verifikojë dhe të gjykojë:

- cilësinë e programit të hartuar me politikën shkencore dhe teknologjike në fushën përkatëse dhe me politikën sektoriale ;
- përcaktimin e objektivave përparësore të programit dhe pajtueshmërinë e tyre me objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të vendit në fushën përkatëse;
- evidentimin e rrugëve e të mjeteve për arritjen e objektivave të programit dhe të mundësive përkatëse të realizimit të tij, në veçanti potencialin shkencor dhe teknologjik, financimin e Programit Kombëtar në çdo fazë të tij;
- arritjen e objektivave të caktuar (i arrin apo i ka arritur objektivat e pritshme) ;
- ndikimin dhe efektin e rezultateve të pritshme ose të arritura deri në çastin e vlerësimit në zhvillimin e vendit, në veçanti në përparimin shkencor, teknologjik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror të vendit ;
- alternativat për arritjen e rezultateve .

Vlerësimi i Programeve Kombëtare ndihmon në formulimin, hartimin e zbatimin e programeve dhe në përgatitjen e në marrjen e vendimeve nga instancat përkatëse (AKKSHI, ministritë, institucionet qendrore, Qeveria,).

Vlerësimi i Programit Kombëtar porositet nga AKKSHI dhe kryhet nga ekspertë të pavarur. Ai mund të porositet edhe nga ministria ose institucioni qendror i interesuar, kur gjykohet e nevojshme për të përmirësuar ecurinë e programit gjatë zbatimit të tij.

### ***Llojet e vlerësimit***

Vlerësimi i Programit Kombëtar bëhet :

- në fillim para miratimit ( vlerësimi për pranim)
- gjatë zbatimit ( vlerësimi gjatë zbatimit)
- në përfundim ( vlerësimi përfundimtar)

#### *Vlerësimi për pranim*

Vlerësimi për pranim bëhet pas kontrollit formal paraprak.

Ky vlerësim ka për qëllim të verifikojë e të gjykojë nëse programi i hartuar i plotëson kërkesat e politikës shkencore dhe teknologjike dhe nëse është i përshtatshëm për t'u paraqitur për miratim në instancat përkatëse.

Vlerësimi, bashkë me dokumentin e Programit Kombëtar, i shërben BA të AKKSHI-t për të marrë vendim për financimin e Programit nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera.

#### *Vlerësimi gjatë zbatimit*

Ky vlerësim bëhet gjatë zbatimit të Programit Kombëtar, zakonisht për periudha 2 vjeçare dhe ka për qëllim të verifikojë e të gjykojë nëse programi zbatohet sipas ecurisë së parashikuar, jep siguri për arritjen e objektivave të tij dhe nëse duhen bërë ndryshime e përmirësime në strategjinë e zbatimit të programit.

#### *Vlerësimi përfundimtar*

Vlerësimi përfundimtar bëhet në përfundim të Programit Kombëtar dhe ka për qëllim të verifikojë e të gjykojë nëse programi përkatës i ka arritur objektivat e caktuar dhe nëse ka dhënë rezultatet e pritshme duke shikuar mundësinë e përfshirjes së këtyre rezultateve në programet e ardhëshme.

Ai analizon mënyrën sipas së cilës janë dhënë dhe përdorur burimet e financimit dhe mjetet e tjera duke bërë krahasim edhe me parashikimet fillestare të planifikimit të financimit. Ai mund të shërbejë për AKKSHI-n për të verifikuar nëse financimi i programit e ka përmbushur funksionin e paracaktuar të tij.

## **V. GRUPI I EKSPERTEVE**

### ***Qëllimi i Misionit***

Ekspertët thirren nga AKKSHI (DPK) për të vlerësuar Programin Kombëtar në një nga llojet e vlerësimit: për pranim; gjatë zbatimit; mbas përfundimit.



## **Zgjedhja e ekspertëve**

Ekspertët zgjidhen ndër shkencëtarët dhe specialistët më të mirë të fushës që mbulon programi dhe që nuk janë të angazhuar drejtperdrejt në hartimin e Programit Kombëtar përkatës. Ekspertët punojnë si rregull pa shpërblye nga puna.

Si ekspertë mund të thirren edhe shkencëtarë e specialistë të huaj.

## **Misioni i ekspertizës**

Për çdo Program Kombëtar thirren 2 - 4 ekspertë një nga të cilët caktohet kryetar i grupit. Ekspertët kanë për detyrë të japin vlerësime objektive të Programit Kombëtar, në përputhje me detyrën që u caktohet.

## **Raportimi i ekspertëve**

Ekspertët hartojnë një raport vlerësimi në përputhje me skemën përkatëse të vlerësimit të paraqitur në shtojcën Mod. PR 02. Raporti i ekspertëve është produkt i punës së tyre të pavarur dhe nuk mund të ndryshohet prej askujt. Raporti i vlerësimit i nënshkruar nga të gjithë ekspertet dorëzohet në AKKSHI.

## **Procedura e punës së Grupit të Ekspertëve**

Për vlerësimin e Dokumentave të Programeve Kombëtare (për pranim; gjatë zbatimit; përfundimtar) ndiqet kjo procedurë:

**a) Kontrata:** AKKSHI që porositi vlerësimin, lidh një kontratë me grupin ekspertëve. Në kontratë përcaktohen kushtet e kryerjes së ekspertizës, afati i dorëzimit të raportit të ekspertëve dhe shpërblye të tyre (shih shtojcën Mod. PR 04).

**b) Përgatitja paraprake:** DPK në AKKSHI, që ka për detyrë ndjekjen dhe zbatimin e Programeve Kombëtare, thërret dhe njuh ekspertët me dokumentacionin themelor (kjo Procedurë; Politika Shkencore dhe e Zhvillimit Teknologjik; Politikat sektoriale; Programi Kombëtar; materiale të përdorura nga Grupi i Programit; Raporte për gjendjen e zbatimit të Programit Kombëtar; vlerësime të mëparshme; raporte shkencore e teknike, etj) sipas rastit në përputhje me llojin e vlerësimit (për pranim; gjatë zbatimit; përfundimtar).

**c) Takime:** Grupi i Ekspertëve takohet :

- me Grupin e Programit (vlerësimi për pranim);
- me Grupin Shkencor Këshillimor (vlerësimi gjatë zbatimit dhe vlerësimi përfundimtar);
- me institucione e specialistë të lidhur me Programin Kombëtar për të kërkuar informacione plotësuese dhe për të dëgjuar shpjegimet e tyre;

**d) Raporti paraprak:** Grupi i ekspertëve përgatit raportin paraprak për vlerësimin, të cilin ja paraqet:

- Grupit të Programit (vlerësimi për pranim);
- Grupit Shkencor Këshillimor (vlerësimi gjatë zbatimit dhe vlerësimi përfundimtar), me qëllim që të dy palët të verifikojnë saktësinë e të dhënave aktuale dhe të përgatiten për të reflektuar për vërejtjet eventuale;

**e) Dorëzimi i raportit:** Grupi i ekspertëve përgatit e dorëzon raportin përfundimtar.

AKKSHI, (DPK) ka të drejtë të kthejë për plotësim raportin e ekspertëve nëqoftëse ai nuk është hartuar sipas modelit përkatës, pa ndikuar në përmbajtjen e tij.

## **VI. MIRATIMI I PROGRAMEVE KOMBËTARE**

### ***Paraqitja e Programeve Kombëtare në KPShZhT***

1. AKKSHI (DPK) ja dërgon raportin e ekspertëve për pranim Grupit të Programit.  
Nëqoftëse e gjykon të nevojshme dhe në rast vërejtjesh të rëndësishme nga ana e grupit të ekspertëve, AKKSHI organizon takim të Grupit të Programit me Grupin e ekspertëve për të dëgjuar komentet e Grupit të Programit.  
Në çdo rast, Grupi i Programit, brenda 7 ditëve, përcjell me shkrim në AKKSHI vërejtjet që ka për raportin e ekspertëve.
2. Komisionet e Vlerësimit pranë AKKSHI-t shqyrtojnë Programet Kombëtare, raportet përkatëse të ekspertëve për pranim dhe vërejtjet eventuale të Grupit të Programit për raportin e ekspertëve dhe japin mendim (me shkrim), në veçanti për ndryshimet dhe përmirësimet që duhen bërë në secilin Program Kombëtar.
3. AKKSHI (DPK) i kërkon Grupit të Programit që brenda 7 ditëve të pasqyrojë në Dokumentin e Programit Kombëtar vërejtjet eventuale. Dokumenti i rishikuar konsiderohet i gatshëm për miratim.
4. AKKSHI (DPK) përgatit dokumentacionin për Programet Kombëtare për t'ja paraqitur BA të AKKSHI-t. Për secilin Program Kombëtar në sekretarinë e AKKSHI depozitohen:
  - a) dokumenti i Programit ;
  - b) raporti i ekspertëve për pranim;
  - c) mendimi i ministrisë, i institucionit qendror dhe Akademisë së Shkencave.
  - d) relacioni për projektvendimin e BA për miratimin e Programeve Kombëtare;
  - e) projektvendimi i BA për miratimin e Programeve Kombëtare;
6. Anëtarëve të BA shpërndahen nga sekretaria e tij materialet b-c, pika 5 dhe Skeda Informative e Programit nga materiali a, pika 5.

### ***Miratimi i Programeve Kombëtare***

BA shqyrton dhe miraton Programet Kombëtare, financimin në tërësi (për gjithë periudhën), cakton financimin për vitin përkatës për secilin Program Kombëtar dhe merr vendimin përkatës.

Në financimin për vitin përkatës përcaktohen:

- financimi nga buxheti i shtetit ;
- financimi nga burime të tjera të siguruara ;

Në financimin në tërësi përcaktohen :

- financimi i mundshëm nga buxheti i shtetit ;
- financimi i mundshëm nga burime të tjera.

Vendimi i BA për financimin për vitin përkatës bëhet ekzekutiv në bazë të procedurave përkatëse për dhënien dhe administrimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera.

### ***Shpallja e Programeve Kombëtare***

AKKSHI u përcjell ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, Shkollave të Larta, instituteve e qendrave kërkimore, etj., vendimin e BA për miratimin dhe financimin e

Programeve Kombëtare. Ajo kujdeset për njohjen e Vendimit të BA të Programeve Kombëtare nga institucionet shkencore, komuniteti shkencor, nga ndërmarrjet dhe firmat prodhuese e ato të shërbimit, si dhe nga opinioni publik.

### ***Dosja e Programit Kombëtar***

AKKSHI, për secilin Program Kombëtar, krijon Dosjen e Programit Kombëtar (DoPK).

DoKP përmban:

- dokumentin e Programit Kombëtar;
- raportin e ekspertëve për vlerësimin për pranim ;
- vendimin e BA për miratimin dhe financimin e Programeve Kombëtare;
- dokumentin për dhënien e financimit përkatës.

Dosja plotësohet vazhdimisht me dokumentacionin që krijohet gjatë zbatimit dhe në përfundim të Programit.

## **VII. FINANCIMI I PROGRAMEVE KOMBËTARE**

### ***Burimet e Financimit***

Për financimin e Programit Kombëtar, AKKSHI evidenton, parashikon dhe/ose siguron burime financimi nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera, për t'i përfshirë në financimin e Programit të dhënë, duke u rekomanduar instancave përkatëse të marrin vendime për dhënien e tyre.

Burimet e financimit të Programit Kombëtar janë :

- a) fonde buxhetore nga buxheti kombëtar dhe buxheti lokal
- b) fonde jo buxhetore nga të ardhurat e institucioneve zbatuese të projekteve dhe të pushtetit lokal
- c) fonde të firmave prodhuese që përbehen nga :
  - fonde direkte që firmat prodhuese venë në dispozicion të njësive shkencore të tyre ose të njësive shkencore të kontratuara prej tyre, për bashkëfinancim (me fondet publike) të Programit Kombëtar ;
  - fonde indirekte të firmave prodhuese, që përbehen nga sponsorizimet e tyre, etj.
- d) fonde të huaja, që jepen në kuadrin e bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh me vende të tjera dhe me organizatat ndërkombëtare.
- e) fonde të tjera të vendit që përdoren për bashkëfinancim në kuadrin e Programit Kombëtar.

### ***Financimi Total***

Financimi Total për Programin Kombëtar paraqet fondin (vleren totale) që Grupi i Programit Kombëtar parashikon për zbatimin e programit, gjatë gjithë kohës së zbatimit të tij, duke e ndarë atë sipas çdo viti financiar.

### ***Financimi buxhetor***

Financimi buxhetor për Programet Kombëtare paraqet shumën e fondeve që Qeveria jep çdo vit për të mbështetur zbatimin e Programeve Kombëtare.

Financimi buxhetor për Programet Kombëtare është zë më vete në buxhetin e shtetit për vitin përkatës.

### ***Financimi i siguruar***

Financimi i siguruar përbëhet nga fondet, që në çastin e hartimit e të miratimit të Programit Kombëtar janë të siguruara (nga vazhdimi i financimit të mëparshëm, nga programe e projekte të miratuara më parë, nga burime të huaja e të tjera). Këto evidentohen më vete.

### ***Financimi potencial***

Fondet e premtuara për financimet vjetore të Programeve Kombëtare nga burime të ndryshme, që nuk janë dhënë ose nuk janë vënë në dispozicion të Programit Kombëtar, deri në çastin e miratimit të financimit të Programeve Kombëtare nga BA, përbëjnë financimin potencial të Programit Kombëtar. Këto financime nuk përfshihen në Vendimin e BA për Financimin e Programeve Kombëtare. Ato mbeten në potencë për t'u siguruar

nga organizmat që përmenden në paragrafin VII.1 dhe për t'u vënë në dispozicion të Programeve Kombëtare vitin pasardhës, ose kur është e mundur gjatë vitit në vazhdim.

### **Objekti i financimit**

Nga fondet e Programeve Kombëtare financohen :

**a)** a.1: Shpenzime për studime fizibiliteti, në të cilat hyjnë:

- honorare për anëtarët e grupit të projektit për pjesën e studimit që do të kryejnë në projekt duke lidhur nenkontrata me drejtuesin e grupit;
- shpenzime udhëtimi brenda e jashtë vendit për realizimin e studimit të projektit;
- shërbime nga të tretë për realizimin e studimit të projektit;

a.2: Shpenzime të tjera që nuk hyjnë në pikën “a.1”

- shpenzime .....
- shpenzime ..... (pagese qeraje, simpoziume, botime, ... .);

**b)** Shpenzime kapitale, në të cilat hyjnë:

- shpenzime për pajisje, laboratorë, impiante pilote, mjete për lëvizje në terrene të vështira, etj. me vlera të mëdha kur këto kërkohen për objektivat e Programit dhe do të përdoren për kohë të gjatë (5 vjet e lart) edhe pas përfundimit të Programit (pajisje të mëdha);
- shpenzime për pajisje e makineri të tjera (shpenzime të tjera kapitale);
- ndërtime;

**c)** Asistencë teknike e huaj në të cilën hyjnë:

- shpenzime për ekspertët dhe specialistët e huaj që thirren në kuadrin e Programit Kombëtar (shpenzime udhëtimi, paga, pritje, etj).

**d)** Shpenzime funksionimi në të cilat hyjnë :

- shpërblime për Grupin Shkencor Këshillimor;
- shpërblime për ekspertët, që thirren për vlerësim (shpenzime për ekspertizat).

## VIII. ZBATIMI, NDJEKJA DHE RAPORTIMI PËR PROGRAMET KOMBËTARE

### *Zbatimi i Programeve Kombëtare*

Programet Kombëtare realizohen nëpërmjet projekteve të kërkimit e të zhvillimit në zbatim të tyre, për të cilat veprohet në bazë të Procedurës Nr. 2 të AKKSHI-t "Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit e të Zhvillimit", dhe Procedurës Nr. 3 të AKKSHI "Për vlerësimin e projekteve që financohen në kuadrin e Programeve Kombëtare të Kërkimit e të Zhvillimit".

DPK në AKKSHI ngarkohet me administrimin e Programit Kombëtar për zbatimin dhe ndjekjen e Programit Kombëtar.

Drejtoria e Programeve Kombëtare dhe Sektori i Financës në AKKSHI ndjekin zbatimin e Programeve Kombëtare që administrojnë AKKSHI. Kur konstatohen të meta, dobësi dhe shkelje në zbatimin e programit, AKKSHI propozon e merr masa për përmirësimin e gjendjes, duke i propozuar BA deri në ndërprerjen e financimit të Programit.

DPK, AKKSHI e ngarkuar me zbatimin dhe ndjekjen e Programeve Kombëtare ka këto të drejta e detyra kryesore :

- përpunon dhe koordinon planifikimin vjetor të punës për Programin Kombëtar dhe ndjek zbatimin e tij;
- bashkërendon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve e njësive shkencore të angazhuara në zbatimin e Programit Kombëtar;
- përgatit kërkesat (propozimet) për financimin e Programit Kombëtar nga buxheti i Shtetit dhe burimet e tjera për vitin pasardhës sipas rregullave përkatëse;
- propozon shpërndarjen e financimit sipas projekteve (të kërkimit e të zhvillimit) për zbatimin e Programit Kombëtar, të cilat kanë fituar gjatë konkurimit (të kryer sipas Udhëzimit përkatës);
- kërkon informacione nga institucionet shkencore që punojnë për zbatimin e Programit Kombëtar, sidomos për shpenzimet e fondeve sipas destinacionit, ndjek veprimtaritë e tyre.
- propozon ndërprerjen e financimit të atyre projekteve që i gjykon se nuk ecin sipas parashikimit duke kërkuar kryerjen paraprake të ekspertizës së ecurisë së projektit, sipas udhëzimit për vlerësimin e projekteve ;
- propozon mbështetje me financime të mëtejshme për ato projekte që pa përfunduar e kanë harxhuar për shkaqe të përligjura (inflacion, pakësim fondesh nga organizmat financuese, etj.) fondin e dhënë sipas destinacionit, duke kërkuar kur e gjykon të arsyeshme kryerjen paraprake të ekspertizës;
- analizon rezultatet e punës vjetore për zbatimin e Programit Kombëtar dhe përgatit raportin përkatës ;
- shqyrton raportet e vlerësimeve të ekspertëve, të dërguara në AKKSHI dhe merr masa për pasqyrimin e vërejtjeve e rekomandimeve në ecurinë e mëtejshme të Programit Kombëtar;
- bashkëpunon me BA për vlerësimin e Programit Kombëtar.

DPK në AKKSHI, për Programin Kombëtar evidenton, ndjek dhe raporton shpenzimet që kryhen në kuadrin e Programit Kombëtar sipas rregullave në fuqi dhe Procedurave të AKKSHI-t për këtë veprimtari.

Për të ndihmuar në ecurinë e Programit Kombëtar, pranë DPK në AKKSHI, ngrihet Grupi Shkencor Këshillimor i Programit Kombëtar (më poshtë Grupi Shkencor), i përbërë nga shkencëtarë dhe specialistë përfaqësues të institucioneve shkencore të lidhura me realizimin e programit të dhënë. Grupi Shkencor funksionon si rregull pa shpërndarje nga puna.

Numri, përbërja dhe Kryetari i Grupit Shkencor caktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKSHI-t në bazë të propozimeve të DPK së ngarkuar për zbatimin dhe ndjekjen e Programit Kombëtar.

Grupi Shkencor kryen këto detyra:

- konsulton Drejtorinë e Programeve Kombëtare për probleme shkencore sipas kërkesës që ka drejtorja, veçanërisht lidhur me ndryshime të përgjithëshme që duhen bërë në strategjinë, objektivat, qëllimet, financimin e programit, etj;
- shqyrton dhe harton listën e projekteve të kërkimit e të zhvillimit për zbatimin e Programit Kombëtar dhe financimet përkatëse që i paraqiten titullarit të AKKSHI-t për miratim;
- shqyrton dhe jep mendim për rezultatet e punës vjetore dhe përfundimtare për projekte të veçantë dhe për programin në tërësi;
- jep mendim për raportet e vlerësimit të programit dhe të projekteve.

Pjesmarrja në Grupin Shkencor shpërblehet sipas dispozitave ligjore në fuqi, nga fondet që vihen në dispozicion të Programit Kombëtar për funksionimin e tij.

### ***Ndjekja dhe raportimi për Programin Kombëtar***

Raportimi vjetor dhe raportimi përfundimtar për realizimin e Programit Kombëtar përgatiten në bazë të Udhëzimit Nr.05 të AKKSHI-t “Për mënyrën e raportimit mbi zbatimin e Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit”.

AKKSHI, pasi bën vlerësimin përfundimtar të Programit Kombëtar paraqet në BA raportin përkatës dhe vlerësimin e ekspertëve.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**GERON KAMBERI**



## II. PËRMBAJTJA

(Plotësoni çdo rubrikë në fletë të veçantë)

### **1. Gjendja ekzistuese në fushën përkatëse të kërkimit e të zhvillimit. Arritjet botërore. Gjendja në vend.**

.....

.....

.....

.....

### **2. Motivimi i ndërmarrjes së programit duke u mbështetur;**

- në politikën shkencore dhe teknologjike kombëtare dhe në politikën sektoriale;
- në objektivat e përgjithshëm të zhvillimit të vendit në fushën përkatëse;
- në mundësitë përkatëse të realizimit të tij (potenciali shkencor dhe teknologjik);
- planifikimi periodik i buxhetit të shtetit dhe i buxhetit të shkencës, si dhe burimet e tjera të financimit;
- në rezultatet e arritura në programe e projekte të përfunduara më parë, etj.

.....

.....

### **3. Drejtimit parësore të kërkimit e të zhvillimit teknologjik sipas fushave të veprimtarisë shkencore, shoqërore e kulturore.**

.....

.....

.....

## II. PËRMBAJTJA (Vazhdim)

### **4. Objektivat e kërkimit dhe të zhvillimit**

#### *Objektivi Nr. 1*

Rezultatet e pritshme. Afatet. Institucionet që do të punojnë.

#### *Objektivi Nr. 2*

Rezultatet e pritshme. Afatet. Institucionet që do të punojnë.

#### *Objektivi Nr. ....*

- Ndikimi i rezultateve të pritshme në zhvillimin socialekonomik, në veçanti :
- ndikimi i rezultateve të kërkimit bazë e të zbatuar
- në arsim e kulturë,
- në shërbime shkencore e teknologjike,
- në kërkimin për zhvillimin teknologjik,
- në nivelin e kërkimit shkencor në vend në raport me botën;
- ndikimi i rezultateve të zhvillimit teknologjik
- në prodhimin material,
- në transferimin e teknologjisë,
- në kërkimin shkencor,
- në patentim.

**I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME \***

**1** .-----

(Titulli /Emërtimi i programit)

**2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit/**

**Drejtoria e Programeve Kombëtare,** tel/fax: +355 4 2 222 409;  
www.akkshi.gov.al

(Ministria /institucioni qendror përgjegjës), (Drejtoria (njësia) e ngarkuar)

Tel.----- Fax. ----- E-mail

**4.** Institucionet shkencore / Shkollat e larta të përfshira në program

-----Tel.----- Fax.-----

**5.** Fushat e veprimtarisë që lëvron programi

**a)** Fushat e veprimtarisë shkencore e zhvillimore

-----

-----

**b)** Fushat e veprimtarisë ekonomike, shoqërore e kulturore

-----

-----

**6.** Afati / Kohëzgjatja -----

(Fillim- mbarim)

**7.** Financimi total ( milion lekë) -----

-----

\*) Shtoni fletë të tjera nëqoftëse nuk mjafton vendi.

**III. FINANCIMI***( Shihni pjesën e VII të udhëzimit)***1. Tabelë përmbledhëse e financimit të programit.**

Titulli/ Emërtimi						
Emërtimi	Gjithsej (mijë lekë)	Ndarë në vite				
		I	II	III	...	...
a) Kostoja totale						
b) Financimi i siguruar						
c) Kërkesa për financim ( c = a - b )						

**2. Shpenzimet për programin sipas llojit**

Nr		Gjithsej Në mijë lekë (4+5)	Totali		Ndarë në vite								
			S (6+8+..)	K (7+9+..)	I	II		III		...			
					S	K	S	K	S	K	...	...	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	...	...	
1.	Shpenzime operative (a+b) a) Shpenzime të personelit b) Sende e shërbime të tjera												
2.	Shpenzime kapitale (a+b+c) a) Paisje të mëdha b) Shpenzime të tjera kapitale c) Ndërtime												
3.	Asistencë teknike e huaj												
4.	Shpenzime funksionimi (a+b) a) Për Grupin Shkencor b) Për ekspertizat												
	SHUMA (1+2+3+4)												

S - Financimi i siguruar ; K- Kërkesa për financim

**III. FINANCIMI (Vazhdim)****3. Burimet e financimit**

Nr		Gjithsej Në mijë lekë (4+5)	Totali		Ndarë në vite							
			S (6+8+..)	K (7+9+..)	I		II		III		...	
					S	K	S	K	S	K	...	...
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	...	...
1.	Fonde buxhetore											
2.	Fonde jo buxhetore											
3.	Fonde nga firmat prodhuese (a+b) a) Bashkëfinancim b) Sponsorizime											
4.	Fonde të huaja											
5.	Fonde të tjera											
	SHUMA (1+2+3+4+5)											

S - Financimi i siguruar ; K- Kërkesa për financim

**4. Paisje të mëdha**

Nr.	Emërtimi i paisjes Qëllimi i përdorimit	Studimi ose njësia për të cilën kërkohet	Vlera në mijë lekë

**IV. SKEDA INFORMATIVE E PROGRAMIT (SIP)**

(Përmbledhje e dokumentit të Programit Kombëtar)

<b>TITULLI / EMËRTIMI</b>
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT Afati----- (Fillim - Mbarim) Motivimi / justifikimi i ndërmarrjes së programit (jo më shume se 15 rreshta)
Objektivat kryesore (jo më shumë se 15 rreshta)

#### IV. SKEDA INFORMATIVE E PROGRAMIT (SIP) (Vazhdim)

Rezultatet e pritshme dhe ndikimi i tyre (jo më shumë se 15 rreshta)

Financimi i programit	Gjithsej (në mijë lekë)	Ndarë në vite			
		I	II	III	...
Kostoja totale					
Financimi i siguruar					
Kërkesa për financim					